



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr. 75, date 27.12.2007

**“PËR KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT “ISH-REPARTI I
KËPUCARISË”, NË RRUGËN E KAVAJËS, TIRANË”**

Bazuar në ligjin Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “e”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.450, datë 24.6.1996 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.81, datë 28.2.1994 “Për kthimin në banesa të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit Publik” ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.379, datë 26.6.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.81, datë 28.2.1994”, pika 2, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të kalojë në fond banese objektin “Ish-Reperti i Këpucarisë”, në rrugën e “Kavajës”, Tiranë.
2. Ti propozohet K.RR.T.R.SH-se, të reflektojë ndryshimin e destinacionit si rezultat i kthimit të këtij objekti në fond banese.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R I